




Profili Ekonomik i Komunës së Istogut

Fjalja e Kryetarit të Komunës



Të nderuar qytetarë të komunës së Istogut,

Duke e konsideruar Planin Ekonomik të Komunës së Istogut (PEK) si dokument të rëndësishëm multi-sektorial, i cili ka për qëllim të josh investimet nga investitorë të huaj dhe lokal, në mënyrë që të jemi kontribuues në zhvillimin ekonomik të komunës, ne kemi hartuar planin gjithëpërfshirës si program qeverisës i komunës së Istogut me programe të ndryshme dhe të qarta të cilat janë të ndara sipas fushave: Shëndetësi, mirëqenie dhe barazi, arsim cilësor, sport të mirëfilltë, bujqësi e turizëm të zhvilluar dhe mbi të gjitha zhvillim dhe punësim meritator poashtu në bazë të planit tonë qeverisës ne po punojmë për një Istog të mençur e digjital me infrastrukturë moderne e ambient të pastër, ku të gjitha këto përfshinë përkushtimin e komunës së Istogut në investime në resurset njerëzore, ruajtje dhe përparim të bizneseve ekzistuese, tërheqje e bizneseve të reja, planifikim dhe përcaktim të zonave për investim, ofrim i ambienteve të sigurta dhe të përshtatshme për investime direkte të huaja, adoptim i teknologjive moderne dhe shfrytëzimin e tokës së pashfrytëzuar.

Hartimi i këtij dokumenti mbështetet në nevojën për planifikimin e qëndrueshëm dhe afatgjatë të mbrojtjes dhe zhvillimit të planifikuar të komunës së Istogut, si dhe në përmbushjen e obligimeve ligjore që burojnë nga Ligji Nr. 04L-174 për Planifikimin Hapësinor. PEK i Istogut, për ne është një dokument shumë me rëndësi, sepse, ofron një vizion të qartë dhe përcakton orientimet e zhvillimit të ardhshëm ekonomik, shoqëror, fizik dhe hapësinor të qytetit të Istogut. Duke u bazuar në Ligjin nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale ne kemi miratuar Strategjinë për Zhvillimin Ekonomik Lokal me fusha specifike dhe të rëndësishme për krijimin e klimës dhe ambienteve të favorshme për joshjen e investimeve të huaja direkte. Me këtë plan (PEK) vihet në pah modeli ekonomik i Istogut i cili përfshin përshtatshmin e gjer të qëllimeve dhe rezultateve duke synuar shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik lokal, rregullimi urban dhe përmirësimet në infrastrukturë si dhe turizmi i bazuar në potencialin natyror dhe atë kulturor, bujqësia dhe agrobiznesi, hulumtimi i shfrytëzimit të potencialit pyjor dhe energjisë alternative.

Në komunën e Istogut operojnë ndërmarrje biznesore të suksesshme kryesisht bujqësore ku rreth 60 % e qytetarëve janë të angazhuar në këtë sektor dhe prioritet është aftësimi i të rinjve për punë në sektorin e bujqësisë dhe turizmit. Në procesin e hartimit të këtij dokumenti, kemi dëshmuar përkushtim, përgjegjshmëri në punë, por jemi treguar edhe shumë bashkëpunues dhe të hapur në raport me qytetarët, OJQ-ët dhe bizneset e sidomos ndaj investitorëve të huajë dhe lokal, gjithë kjo për arsye të kontributit sa më të madh në zhvillimin ekonomik të komunës tonë.

“Qyteti i Istogut njihet si vend i njerëzve të urtë, njerëzve të mençur e punëtorë dhe jemi duke punuar për një etapë të re të zhvillimeve ekonomike dhe sociale falë implementimit të dokumenteve si PZHK dhe PEK, prandaj ftoj të gjithë qytetarët e Istogut të tregohen unik, të bashkuar në realizimin e këtij vizioni për zhvillimet e ardhshme në Istogut.

Komuna e Istogut



Misioni i Komunës

Komuna synon të krijoj kushte për një Istog të shëndetshëm, me mirëqenie të mirëfilltë dhe i barabartë për të gjithë. Një Istog me arsim cilësor, rini të angazhuar, sport të mirëfilltë, me aktivitete kulturore, bujqësi e turizëm të zhvilluar, e mbi të gjitha gra dhe të rinj të punësuar në qytetin e tyre. Një Istog i mençur dhe digjital me infrastrukturë moderne e ambient të pastër.

Demografia



Sipas rezultateve preliminare të regjistrimit të fundit të popullsisë, komuna e Istogut ka 39,289 banorë.

Të gjinisë mashkullore janë: 19,962

kursetë gjinisë femërore: 19,327 banorë.

Komunitetet që jetojnë në komunë në Istogut janë:

Shqiptar	36,154
Egjiptian	1,544
Boshnjak	1,142
Serb	194
Ashkali	111
Rom	39
Turk	10
Të tjerë	45
Të pa specifikuar	50

Dendësia: 115.5 b/km²

Mosha në % (0-24 vjeç): 62.4%


Vendbanimet

Komuna e Istogut ka 50 vendbanime.




Sipërfaqja e Komunës

Komuna e Istogut ka një sipërfaqe prej 454 km².



Buxheti i Komunës: 13,051,595€

Pronat publike për shfrytëzim (me foto)




Arsimi

- Numri i çerdheve: 5 çerdhe/institucione parashkollore publike dhe 3 private
- Numri i shkollave: 13 shkolla amë dhe 12 shkolla me paralele të ndara fizike
- Numri i fëmijëve në edukim të hershëm: 463
- Numri i nxënësve në shkolla fillore/ të mesme: 6768
- Numri i studentëve në Universitet të qytetit (nëse ka): nuk ka



Shëndetësia

- QKMF: 1
- Spitalet (nëse ka): nuk ka
- Përqindja e imunizimit: 95%
- Njësitë në fshatra: 13



Qasje në shërbimet bazike

Ujë- Banesat e banuara me qasje në ujë në territorin e komunës janë mbi 98 %, ndërsa mbi 70 % me qasje në ujësjellësin publik.

Energji elektrike - Në aspektin e mirëmbajtjes së rrjetit si dhe furnizimin e konsumatorëve me energji elektrike, i tërë konsumi i Istogut, në nivelin distributor, menaxhohet dhe eksploatohet nga Distrikti i Pejës. Në aspektin e planifikimit të zgjerimit të rrjetit distributor kjo njësi participon vetëm me shënimet

nga tereni. Mirëpo i tërë terreni i komunës është i mbuluar 98% me shërbim të energjisë elektrike.

Internet – 90%

Strehim –70%

Kanalizime - Banesat e banuara me qasje në kanalizim janë mbi 90 %, ndërsa me qasje në rrjetin e kanalizimit publik të ujërave të zeza janë më pak se 30 %.

Siguria në Komunë

Tre sektorët më të mëdhenj (sipas vlerësimit të komunës)

Policia	Shëndetësia	Shërbimi i zjarrfikësve dhe shpëtimit
---------	-------------	---------------------------------------

Demografia

Tab. 1. Të dhënat mbi popullsinë – ASK 2011


KOMUNA E ISTOGUT	
Nr. i popullsisë	39,289 b.
Zonat rurale	34,174 b.
Zonat urbane	5,115 b.
Nr. i Vendbanimeve	50
Raporti banim individual/banim kolektiv në [%]	90/10
Kyçje në infrastrukturë të objekteve të banimit në [%]	80%

POPULLSIA		
1	Dendësia	115.5 b/km ²
2	Mosha 0-24vjeç (kryesisht% e moshës së re)	62.4%
3	Familjamesatare	6 anëtarë
4	Nataliteti	Rreth 13% në vit
5	Arsimimi	tektërrituritnë% Mes
		hkuj Femra
		97.54 91.47
6	Fuqia punëtore	25,504

Struktura organizative e Komunës



STRUKTURA ORGANIZATIVE E ORGANEVE KOMUNALE



Buxheti

Tab. 2. Planifikimi i Buxhetit Komunal për 3 vite

Përshkrimi	2022 (buxheti aktual)	2023 (plani)	2024 (vlerësimet)	2025
1. TËHYRATTOTALE KOMUNALE				
1.1 Tëhyratvetanake	1,145,615.00	1,244,588.00	1,295,934.00	1,351,480.00
1.2 Grantetqeveritare	10,466,384.00	11,808,883.00	12,681,958.00	13,120,064.00
1.3 Financim i jashtëm	11,009,500.00	12,752,500.00	1,916,452.00	160,000.00
2. SHPENZIMETTOTALE KOMUNALE				
2.1 Shpenzimetrrjedhëse	11,611,999.00	13,051,471.00	13,932,892.00	14,471,544.00
Pagat dhemëditjet	6,511,000.00	6,852,429.00	7,242,559.00	7,507,364.00
Mallratdhe shërbimet	1,593,959.00	1,656,580.00	1,608,538.00	1,855,724.00
Shpenzimet komunale	202,000.00	200,000.00	200,000.00	200,00.00
Subvencionet dhe transferet	310,000.00	319,000.00	314,000.00	309,750.00
Shpenzimetkapitale	2,995,040.00	4,023,462.00	4,567,795.00	4,598,706.00

Punësimi

Fuqia punëtore në komunën e Istogut llogaritet 40.5%. Shkalla e punësimit është mjaft e ulët, duke marrë për bazë numrin e popullsisë aktive për punë. Shkalla e punësimit është 22.5%

(është llogaritur raporti mes personave të punësuar dhe gjithsej personave të moshës 15-64 vjeç (25 504 persona). Shkalla e papunësisë është 44, 3% apo 4579 persona.


Tab. 3 Popullsia e moshës 15 vjeç e lartë, sipas statusit të aktivitetit aktual - ASK2011

Ekonomikisht aktive	Të punësuar	Të papunësuar, që kanë punuar më parë	Të papunësuar, nuk kanë punuar asnjëherë me parë	Të papunësuar, presin të fillojnë punën në të cilën janë pranuar	Ekonomikisht jo aktiv	Total
10,327	5,748	1,137	3,392	50	18,153	28,480

Tab. 4 Punësimi sipas sektorëve:

Spektori publik (administrata, arsimi, shëndetësia dhe shërbimet sociale)	Spektori i ndërtimtarisë, tregtisë dhe shërbime	Spektori i bujqësisë	Spektori i industrisë
2,333	2,215	705	437

Grafik 1. Përqindja e punësimit sipas sektorëve



Të papunësuar në komunën e Istogut të cilët janë gjithsej të lajmëruar në entin për punësim nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2021 janë 110 raste aktive dhe 172 raste pasive, ndërsa nga janari i vitit 2022 deri më datën 08.09.2022 janë 135 raste aktive dhe 2 raste pasive.

Arsimi

Në komunë gjenden 5 institucione parashkollore publike (çerdhe dhe kopshte) me 350 fëmijë të regjistruar. Arsimi para fillor zhvillohet në objektet e shkollave fillore, ku janë të regjistruar 428 fëmijë. Institucione private janë 3.

Tab.5 Numri i nxënësve sipas niveleve

Niveli	1- 5	6-9	10-12
Numri i fëmijëve	2,914	2,297	1,557

Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët është i organizuar në 13 shkolla fillore amë dhe 12 paralele të ndara. Prej tyre, 2 shkolla amë janë serbe, 1 është shkollë amë-mikse (shqipe-boshnjake) dhe 10 shkolla amë shqipe, ndërsa paralelet e ndara janë 1 mikse dhe 14 shqipe. Në shkollimin fillor janë regjistruar gjithsej 7471 nxënës në 308 paralele.

Hapësira e shkollave, sipas vlerësimeve nga DKA, është 29.69 m²/nxënës.

Raporti gjinor i nxënësve në institucionet e shkollimit fillor dhe të mesëm të ulët është, meshkuj 51% dhe femra 49 %.

Arsimi i mesëm i lartë -

Mësimi i mesëm i lartë është i organizuar në dy institucione shkollore, në gjimnazin “ Haxhi Zeka “në Istog dhe SHMT “MithatFrashëri “në Gjurakoc, ndërsa një paralele e ndarë e SHMT-së funksionon brenda burgut të Dubravës. Numri i përgjithshëm i nxënësve që vijnë në mësimin e mesëm të lartë është 1967 nxënës. Nxënësit janë nga e gjithë komuna dhe udhetojnë në baza ditore, pasi që nuk ka konvikte.

12 shkolla janë të pajisura me kabinet të TIK-ut, në 8 shkolla është investuar me masa të efikasitetit të energjisë, 8 shkolla janë të pajisura me sistemin e kamerave, 10 shkolla kanë projektor, në 7 shkolla janë të vendosur televizor, 5 shkolla janë të pajisura me salla të edukatës fizike dhe një shkollë ka tabelë elektronike. Ndër këto shkolla më të pajisurat janë ato të mesmet – gjimnazi dhe shkolla profesionale teknike.

Shëndetësia

Shërbimet shëndetësore janë të shpërndara në gjithë territorin duke respektuar dendësinë e banimit, me qëllim të ofrimit të mundësisë së njëjtë të qasjes në shërbimin primar shëndetësor.

Shërbimi publik shëndetësor në komunën e Istogut është i organizuar në tri nivele:

- 1.Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), e cila gjendet në Istog (1) – ofron shërbime shëndetësore për 24h, duke përfshirë edhe shërbime shëndetësore shtëpiake.
 2. Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) në Banjë, Vrellë, Rakosh, Gjurakoc (4) – ofrojnë shërbime të kujdesit primar shëndetësor.
 3. Punktet e mjekësisë familjare në Kaliçan, Dobrushë, Saradran, Veriq, Cërkolez, Osojan, Zallq, Shushicë, Dubravë (9) – ofrojnë shërbime mjekësore familjare.
- Në komunë gjenden gjithsej 14 objekte në të cilat ofrohen shërbime shëndetësore.

Kultura, Sporti dhe Rinia

Infrastruktura e institucioneve publike kulturore në Istog përbëhet nga:

- Ndërtesa e bibliotekës;
 - Ndërtesa e shtëpisësë kulturës;
 - Memoriali “Ibrahim Rugova” – në hapësirat e të cilit (poshtë memorialit) mendohet së shpejti të vendoset muzeu i qytetit, pasi që edhe është i destinuar për këtë qëllim.
- Këto gjenden në qendrën komunale, d.m.th. në qytetin e Istogut. Aktivitetet kulturore në vendbanimet tjera të komunës zhvillohen kryesisht në objektet e institucioneve të komunitetit.

Ndër atraksionet kulturore mund të veçohen:

Foto 1. Kullë e restauruar në fshatin Tomoc.



Foto 2. Mulliri për bluarjen e misrit ne fshatin Vrellë (7 km larg qytetit te Istogut) – nga viti 1922 dhe ende vazhdon te jetë funksional



Foto 3. Pjesë të kishës paleokristiane (shek. IV-VI) në Studenicë (8 km nga qyteti).



Foto 4. Burimi i ujit termal me temperaturë deri 49°C.



Resurs me potencialpërzhvillimin e turizmitshëndetësorështëBurimiiUjëravetermalnëBanjë me karakteristikaterapeutike.Uji i Banjës ka cilësi shëruese të sëmundjeve reumatike dhe të sëmundjeve tjera të ndryshme. Banja gjendet në lartësinë mbidetare prej 540 metra, në tarracën bigrene dhe nga të çarat e tokës burojnë disa gurra të nxehta, të vakëta dhe të ftohta minerale. Për nga cilësia e tyre, hyjnë në radhën e ujërave tokësore-alkale, karbo-të tharta dhe me përmbajtje të vogël të sulfurit. Në bazë të mbeturinave të banjës së vjetër dhe të gypave të dheut, është konstatuar se ujërat e Banjës janë shfrytëzuar që nga romakët, pastaj nga sunduesit dhe aristokracia mesjetare e më vonë edhe nga turqit.

Foto 5. Muzeu komunal



Foto 6. Dionisi (Zoti i plleshmërisë) i gjetur në Vrellë.



Jane disa lokalitete te gjetjeve arkeologjike te evidentuara ne Komunen e Istogut si; tuma ilire të evidentuara janë të shekullit VIII-V p.e.s. Vendndodhja e tyre është në anën e majtë të rrugës rajonale Istog-Vrellë, 100m larg rrugës.

Foto 7. Të qethët e deleve



Të qethët e deleve – është një rit tradicional I cili organizohet çdo vit ne bjeshkët e Istogut ne muajin Gusht. Kjo ngjarje tubon një numër të madh të qethtarëve vullnetarë, blegtorëve të shumtë, bashkatdhetarëve dhe qytetarëve që shkojnë për të parë nga afër ritin e qethjes së deleve si dhe për të shijuar bukuritë e Bjeshkëve të Istogut . Përveç vullnetarëve që kryejnë ritin e qethjes, një rit ky i vjetër dhe tashmë tradicional i blegtorëve të kësaj ane pjesëmarrësve te këtij manifestimi u shërbehet ushqim dhe produkte tradicionale të bjeshkës. Pjesë e ngjarjes janë edhe aktivitete të ndryshme rekreative si tërheqja e litarit, hedhja e gurit (gurapeshi), kërcim nga vendi (pupthi). Të gjitha këto aktivitete zhvillohen në formë garuese ku vendet e para marrin edhe shpërblime.

Infrastruktura e institucioneve sportive dhe e hapësirave rekreative në komunën e Istogut përbëhet prej: stadiumit, ndërtesave të sallës sportive, fushave sportive-rekreative shumë

funkcionale, shtigjeve për kalërim (joformale), shtigjeve për ngjitje dhe marshim alpin, shtigje për çiklizëm dhe shkëmbinjtë natyror për ngjitje. Stadiumi I cili si strukturë në vete ka vetëm tribunat dhe ndërtesa e sallës sportive gjendet në Istog. Shumica e fushave të sportit të institucioneve arsimore shfrytëzohet për aktivitete të ndryshme prandaj edhe janë kategorizuar në fusha sportive-rekreative shumë funksionale. Sa I përket kategorive tjera si shtigjeve për kalërim, çiklizëm, ngjitje në shkëmbinjtë etj, të gjitha zhvillohen për shkak të resurseve natyrore ekzistuese.

Ekonomia

Ekonomia në komunën e Istogut kryesisht bazohet në bujqësi me rreth 60 % të qytetarëve të angazhuar në këtë sektor. Sipas të dhënave të komunës, në vitin 2022 ka pasur 2,993 biznese të regjistruara, prej të cilave aktive janë 1,536 biznese. Bizneset në Komunën e Istogut janë kryesisht individuale (mbi 90%), shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (afër 8%) dhe pjesëmarrje të vogël të ortakërive të përgjithshme (1%). Nga bizneset e regjistruara kryesisht dominojnë veprimtaritë si: tregti, transport, ndërtimtari, hotelieri dhe prodhimtari.

Disa nga ndërmarrjet e suksesshme të biznesit me të cilat identifikohet sot Istogu janë:

Qendra rehabilituese termale në Banjë- e privatizuar në vitin 2013, kuprocësi investimit dhe ri zhvillimit të të gjitha përmbytjeve hotelerie dhe shëndetësore të pronarit të ri të qendrës, dhe ekzistenca e planeve hapësinore të aprovuara për Banjën, është arritur pothuajse rikthimi i namit të dikurshëm të kësaj qendre.

Hurdha e peshqve “Trofta” në Istog- e privatizuar në vitin 2004, përmbytjet hoteliere dhe shërbyese janë rinovuar dhe nga AKP konsiderohet si një ndër storiet e suksesit të procesit të privatizimit. Përveç kësaj hurde kryesore, janë të shpërndara edhe disa hurdha tjera nëpër vendbanime të komunës, të cilat shfrytëzojnë resurset e pasura ujore të Istogut.

Fabrika për përpunimin e qumështit dhe lëngjeve “Vita”, e vendosur në ish-fabrikën e përpunimit të drurit “Radusha” në Syne, e privatizuar në vitin 2010, e rinovuar dhe e përshtatur për funksionin e ri. Një ndër prodhuesit e rëndësishëm vendor, produktet e të cilit eksportohen edhe jashtë Kosovës.

Fabrika e pijeve “Sinalco” në Vrellë të Istogut është hapur në vitin 2011, me kapacitet prej 30 mijë litrash në orë, ndërsa për fillim, aty kanë gjetur punë 40 punëtorë. Ndërmarrja “GetrinkeVrella” sh.p.k. (Sinaclo Kosova) është kompani e licencuar nga Sinalcointernational – Gjermani për prodhimin e produkteve të saja dhe distribuimin e tyre në Kosovë dhe Shqipëri.

“Agroproduct” në Syne, e themeluar në vitin 2002 si biznes familjar, merret me aktivitetin e grumbullimit të bimëve mjekuese aromatike (BMA) si dhe kultivimin e tyre. Duke filluar me kapacitete simbolike, ka arritur që në vitin 2015 të ketë 2400 m² sipërfaqe të objekteve. Në vitin 2013 ka investuar 2000 m² sera moderne për kultivimin e fidanëve, ka të siguruar 220 m² sipërfaqe të tharësve dhe 3 dhoma ftohëse në 200 m³ dhe 33 qendra të grumbullimit të organizuara në tërë territorin e Kosovës. Me planet investuese për vitet në vijim, për zgjerim të kapaciteteve të grumbullimit, prodhimit dhe deponimit, premton të shndërrohet si kompania më serioze në këtë fushë, jo vetëm në komunë por në nivel vendi dhe padyshim

paraqet shembull të zhvillimit të biznesit privat. Kjo kompani eksporton produktet e saja ne disa shtete te Evropës perëndimore.

Për tërheqjen e investimeve te huaja direkte, komuna ofron zonën ekonomike e cila ka një sipërfaqe prej 8 ha (tokë ndërtimore), ku aktualisht operojnë 10 biznese. Kjo zone gjendet afër rrugëve kryesore te transportit rrugor, me qasje te shpejt dhe ofron infrastrukturë adekuate bashkëkohore me politika stimuluese bazuar ne praktikat botërore te zhvillimit te këtyre zonave.

Tab. 6 Të dhënat për zonën ekonomike

Lokacioni	3 km nga qendra e qytetit, afër rrugës rajonale Pejë-Mitrovicë
Sipërfaqja	8 ha
Parcela në dispozicion	32 ngastra. Parcela më e madhe është 41,079m ² te sipërfaqes, më e vogla është 3,000m ² .
Infrastruktura	Zona është e pajisur me shërbime te furnizimit me ujë, rrjet te kanalizimit, energjisë elektrike, telefon/internet.
Pronësia	100% Komuna e Istogut
Mundësitë e investimit	Qira
Çmimi i qirasë për token	Duke filluar nga 0.20€ / m ²
E përshtatshme për industrinë:	Industrinë e bujqësisë dhe përpunimit te ushqimit, përpunimin e metaleve, dhe industrinë e përpunimit te drurit, tekstile dhe industrinë e këpucëve, shërbimet teknike dhe te inxhinierisë.

Që nga viti 2013 Komuna ka larguar ngarkesat vjetore komunale për te gjitha bizneset te cilat operojnë ne komunën e Istogut.

Si sektor më pak i zhvilluar ne komunën e Istogut është prodhimtaria. Edhe përkundër potencialeve te mjaftueshme për te zhvilluar prodhimtarinë, si tokës pjellore, burimeve të ujit dhe klimës si dhe moshës së re të popullatës, ky sektor ka nevojë për më tepër investime. Agrikultura ka rol të rëndësishëm në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik dhe agrar duke prezantuar kështu një lëmi me perspektivë për zhvillim. Kjo do t'i siguronte komunës sasi të mjaftueshme të prodhimit, rritjen e të ardhurave të përgjithshme dhe punësimin e banorëve. Tokat me plleshmëri relativisht të volitshme me të cilat disponon komuna, do të jepnin mundësi për ri funksionimin, rritjen e prodhimeve bujqësore e sidomos të zhvillimit të blegtorisë, kopshtarisë dhe pemëve kokërrimëta.

Pastaj, prodhimi i tanishëm i pyjeve të territorit të Istogut është zvogëluar dukshëm nga prerjet e egra të paraluftës dhe ato ilegale që janë mjaft të larta edhe sot, sipërfaqja jo prodhuese e përgjithshme e pyjeve dhe ajo pjesërisht prodhuese është afro 35,9 % apo 1/3 e territorit të përgjithshëm me pyje, duke ditur se sipërfaqet pyjore te komunës se Istogut janë 19.220 ha, prej tyre në sektorin shoqëror janë afro 13.570 ha apo 68,8% ,ndërsa në sektorin privat 5.650 ha apo 32,2%.

Siguria

Komuna e Istogut si edhe komunat tjera te Kosovës ka te themeluar Këshillin Komunal për Siguri dhe Bashkësi. Struktura e KKS-së përfshin një gamë të gjerë akterësh ndër-sektorial, të cilët luajnë një rol afatgjatë të rritjes së sigurisë në bashkësi. KKS-jë ka një qasje të gjerë në ofrimin e sigurisë si dhe përgjegjësi për ofrimin e një mjedisi të sigurt. Pra përveç policisë, siguria e qytetarëve është përgjegjësi edhe e strukturave tjera te nivelit lokal si dhe shoqërisë civile. Andaj roli i KKS-së është te siguroj një forum te veçantë, për t'i bashkuar ne një vend këto grupe te interesit.

Bujqësia

Komuna e Istogut ka një potencial të madh në sektorin e bujqësisë, pasi ka tokë cilësore, klimë të volitshme dhe burime ujore, si dhe kapacitet të mjaftueshëm njerëzor për prodhimtari bujqësore. Sipas regjistrimit të bujqësisë të vitit 2014 nga ASK, fuqia punëtore në bujqësi llogaritet 13,921 persona. Numri i fermerëve te regjistruar ne komunën e Istogut është 3,717 fermer sipas NIF.

Tab. 7 Sipërfaqet në hektarë sipas llojit të tokës dhe të kafshëve


Nr. i ekonomiv e familjare	Nr. i ferma ve sipas NIF	Toka bujqësor e-ara	Livadhe dhe kullosa	Drithëra/ grur ne subvencio ne	Drithëra – grur totali	Pemisht e ne subvencione	Pemisht e totali	Sip. me sera ne subvencione	Sip. totale me sera	Sipërfaqe me bimë mjekësore	Bime mjekësore aromatike/Organike	
4410	3717	9091.08	11124.83									
Totali	Toka bujqësore livadhe dhe kullosa		20215.91	2.338,54	2.805,63	324.26	389.06	1.17	1.40	45.43	109.38	
Kafshët												
Nr. i ekonomiv e familjare	Nr. i ferma ve sipas NIF	Gjedhe për qumështore/S	Gjedhe për qumështore /S	Dele qumështore/S		Dele qumësh tore/Tot ali	Dhi qumësh tore/ S	Dhi qumësh tore/ Total i	Viqa për majmëri	Bletë /S	Bletë total	Pula vojse
14745.00	625	4.299	5.158	7.701		9.240	1.341	1636	316	8.028	9630	30.500

Tab. 8 Shkalla e punësimit të fermerëve dhe arsimimit

Te punësuar ne sektorin e bujqësisë	13,921 (58 % femra)
Vetëm shkollën fillore	30 %
Pa shkollën fillore	6 %
Shkollë te mesme bujqësore, fakultet	1.5 %

Komuna e Istogut dallohet për prodhimtarin bujqësore te produkteve si: qumësht, pemëtari, prodhimtari organike e bimëve aromatike, bletari.

Grafik 2. Sipërfaqja e tokës bujqësore



Ambienti

Territori i komunës së Istogut ka një sipërfaqe prej 45,384 ha, apo 4.17% të territorit të Kosovës. Aktiviteti kryesor ekonomik është bujqësia dhe blegtoria.

Në pjesën veriore të komunës shtrihen rajonet e larta të cilat kufizohen me masivin e bjeshkëve me lartësi mbidetare deri në 2,155m. Në pikëpamjen e kushteve orografike, territori i komunës së Istogut ka kushte të volitshme për prodhimtarinë bujqësore për shkak të klimës së volitshme, pasurisë së burimeve të ujit dhe për arsye se deri në 600m të lartësisë mbidetare gjinden 23,240 ha, apo 51.19% sa ka sot sipërfaqe tokësore. Prodhimi më intensiv i bujqësisë dhe prodhimtarisë perimore mund të organizohet në sipërfaqe deri në 500m të lartësisë mbidetare, ku këto sipërfaqe të përgjithshme janë afro 40,160 ha, apo 31.19% dhe gjenden nëpër luginat e lumenjve që shtrihen në tërë territorin e komunës së Istogut.

Në komunën e Istogut, si toka të punuara dhe kopshte shfrytëzohen afro 12,176 ha, ndërsa si livadhe dhe kullosa afro 12,620 ha. Sipërfaqet në lartësi mbidetare 500-600m janë të përshtatshme për prodhimtarinë e pemëve e sidomos në pjesën lindore të komunës.

Sa i përket ujërave në komunën e Istogut, burimet janë të mira, me ujë të pastër kimikisht dhe bakterologjikisht. Këto burime njihen si burime me ujë të fortë, meqë rrjedhin nga shkëmbinjtë gëlqeror, dhe nuk sendimentojnë. Në bazë të analizave, del se uji i burimeve të Istogut është një ndër ujërat më të pastra, kurse fortësia (ph) e tyre është 7.81.

Infrastruktura dhe Transporti

Istogu ka lidhje të mira me qendrat rajonale në Kosovë, po ashtu edhe me qytete të rëndësishme në shtetet fqinje. Rruga kryesore Mitrovicë-Pejë kalon në territor të komunës

dhe disa rrugë e lidhin komunën me Prishtinën e Klinën. Në pjesën veriore të komunës, janë lidhjet rrugore të komunës me Malin e Zi, Serbinë dhe komunën e Zubin Potokut. Megjithatë, lidhje të mira ka me Rozhajën (Mal i Zi) e cila realizohet përmes rrugëve Istog-Pejë-Rozhajë, dhe Istog-Radac-Rozhajë, ndërsa përmes rrugës Istog-Rakosh-Cërkolez lidhet me komunën e Zubin Potokut dhe Serbinë.

Në territorin e komunës nuk kalojnë rrugët magjistrale por vetëm rrugët rajonale të cilat janë R-101, R-102, R-104 dhe R-221. Istogu nuk ka rrugë hekurudhore, mirëpo stationi më i afërt është 15 km. Ndërsa distanca deri tek aeroporti është 70 km. Porti më i afërt detar është ai i Durrësit 500 km largësi dhe ai i Tivarit me 277 km largësi.

Turizmi

Natyra e larmishme në komunën e Istogut me bjeshkët, malet, peizazhe të bukura dhe dinamike, resurset natyrore si ujërat termal dhe shpellat, trashëgimia kulturore – kullat, mullinjtë, xhamitë, kishat etj – janë potenciale për zhvillimin e turizmit. Edhe pse ende i paorganizuar në nivelin qendror dhe atë lokal, turizmi në komunën e Istogut do të bëhet një veprimtari e rëndësishme ekonomike.

Zhvillimi i turizmit si veprimtari ekonomike në territorin e komunës, dallohet për nga tipet e përcaktuara sipas potencialit: në zonën “bjeshkë” potenciali natyror, në zonën “rrëzë” potenciali i trashëgimisë kulturore dhe në zonën “fushë” ujërat termal.



Zona “Bjeshka”

Natyra dhe turizmi - Relievi kodrinor i zonës ofron mundësitë për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme rekreative të cilat janë ngushtë të lidhura me resurset dhe trashëgiminë natyrore. Ecja dhe shëtitja janë format më të mira për ta përjetuar natyrën. Ndërsa ecja apo çiklizmi malor në distancave të gjata ose nëpër terren të vështirë, kërkon aftësi fizike dhe njohuri. Aktivitetet tjera të cilat mund të zhvillohen këtu janë alpinizmi, çiklizmi malor, kampimi dhe gjuetia.

Agrikultura (Blegtoria, bimët mjekuese) - Kushtet klimatike dhe toka në këtë zonë mundësojnë kultivimin e bimëve të ndryshme mjekësore, të cilat mund të përdoren në industrinë farmaceutike. Rritja e bimëve mjekësore dhe e luleve është e rëndësishme edhe për bletarinë, prodhimin e mjaltit dhe produkteve tjera bletare. Livadhet dhe kullosat si resurs dhe potencial për blegtori, shtrihen kryesisht në këtë zonë. Blegtoria, si veprimtari ekonomike në këtë zonë, kryesisht zhvillohet më afër vendbanimeve dhe si veprimtari sezonale (gjatë verës) në kullosa dhe livadhe.

Pylltaria - Zona malore ofron mundësi të zhvillimit të veprimtarive të lidhura me resursin e pyjeve. Zona malore është e mbuluar me pyje të larta të cilat mund të shfrytëzohen për prodhimin e lëndës drunore, prodhimtari të vogla të zdrukthëtarisë dhe prodhimit të biomasës e cila mund të përdoret për ngrohje dhe prodhimin e energjisë në shkallë të vogël. Shfrytëzimi i resurseve pyjore duhet të jetë i qëndrueshëm, me prerje të kontrolluar dhe politikë të pyllëzimit.

Speleoturizmi - Numri i madh i shpellave në bjeshkë janë resurse me potencial për zhvillimin e turizmit. Speleoturizmi nënkupton vizitën e shpellave dhe labirinteve natyrore. Kushtet e vështira, si lagështia dhe mungesa e dritës, janë faktorë që e bëjnë speleoturizmin aktivitet aventuristik dhe për këtë arsye është shumë i popullarizuar për moshat e reja.

Zona “Rrëza”

Lidhjet e mira me rrethinën si dhe potencialet dhe resurset në këtë zonë mundësojnë zhvillimin e një numri të madh të veprimtarive ekonomike. Bazuar në këto veprimtari, funksionet kryesore të zhvillimit në këtë zonë janë:

Agrikultura

- Akuakultura
- Apikultura
- Agroturizmi dhe Turizmi rural
- Turizmi kulturor
- Ndërtimtaria
- Shërbimet kryesore

Agrikultura - Kufizimi me bjeshkën, përkatësisht livadhet dhe kullosat janë potencial për zhvillimin e blegtorisë si një nga veprimtaritë kryesore ekonomike të kësaj zone.

Turizmi kulturor

Tradita, trashëgimia kulturore dhe lokalitetet arkeologjike në komunën e Istogut, janë potencial për zhvillimin e turizmit kulturor. Kultura e përcjellur me një marketing të mirëfilltë, është mjet i rëndësishëm për t’i joshur turistët e interesuar në trashëgimi kulturore, histori dhe arkeologji. Numri i madh i ndërtesave të trashëgimisë kulturore, kulla, mulli, objekte të religjionit, lokalitete arkeologjike etj. janë resurse të cilat mund të përdoren nga asociacione apo korporata të cilat merren me mirëmbajtjen e tyre, për promovimin e këtij tipi të turizmit.

Ndërtimtaria

Zhvillimi i sektorit të ndërtimit ka rëndësi të madhe në zhvillimin e ardhshëm ekonomik të Istogut. Ndërmarrjet ndërtimore do të luajnë një rol të rëndësishëm, qoftë në kryerjen e punëve të ndërtimit, apo si investitorë të besueshëm lokal, gjë që drejtpërdrejt ndikon në krijimin e vendeve të reja të punës.

Zona “Fusha”

Lidhjet e mira me rrugë rajonale, me qendrën kryesore dhe subqendrën dhe në mes vet vendbanimeve në komunën e Istogut, mundësojnë që edhe pjesët tjera të kësaj zone të jenë aktive dhe konkurruese për zhvillimin ekonomik në komunë, sidomos të turizmit të bazuar në kultivimin e peshkut, shfrytëzimit të ujit termomineral, të trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

Bazuar në resurset, potencialet e zhvillimit dhe numrin e popullsisë që jeton dhe punon këtu, kjo zonë është quajtur ‘Kopshti, uji dhe hurdat’.

Funksionet kryesore për zhvillim në këtë zonë janë:

- Agrikultura
- Apikultura
- Turizmi shëndetësor
- Shërbimet

Agrikultura - Istogu ka një potencial të madh për prodhimtarinë bujqësore, e sidomos të llojeve të ndryshme të drithërave, perimeve dhe pemëve. Prodhimtaria kryesisht është në ngastra të vogla me kapacitete të vogla, prandaj një organizim më i mirë i strukturave dhe njësive të kësaj veprimtarie është i domosdoshëm në të ardhmen. Për shfrytëzimin sa më të mirë të potencialeve të agrikulturës, janë të nevojshme aftësi dhe njohuri shtesë për prodhim dhe marketing, si dhe rritja e njësive bujqësore me madhësi mesatare. Përveç prodhimit, edhe përpunimi dhe përsosja e produkteve ushqimore janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e kësaj industrie. Për prodhimin e produkteve kualitative është e nevojshme fuqi punëtore e aftë, prandaj trajnimet dhe kurset profesionale janë ato që duhet ta plotësojnë prodhimtarinë bujqësore dhe përpunimin e produkteve ushqimore. Për shkak se shumica e territorit në këtë zonë është rrafshinore, arat e mbjella me drithëra dhe pemë dhe perime duhet të mbrohen dhe zgjerohen.

Apikultura- Zhvillimi i kësaj veprimtarie është ngushtë i lidhur me bujqësinë e sidomos me kultivimin e pemëve të cilat sigurojnë kushte të mira dhe stimulojnë bletarinë. Ndikim tjetër pozitiv në zhvillimin e kësaj veprimtarie kanë edhe lulet dhe bimët tjera si erëzat, sidomos ato që rriten në zonat tjera, në bjeshkë dhe rrëzë. Prodhimet nga bletaria, mjaltja dhe dylli kanë përdorim të gjerë edhe nga kompanitë farmaceutike dhe kozmetike si përbërës të medicinës dhe kozmetikës.

Turizmi shëndetësor- Burimi i ujërave termal në Banjë është një resurs me potencial për zhvillimin e turizmit shëndetësor për klientelen kombëtare dhe ndërkombëtare. Zhvillimi i kësaj veprimtarie ka një traditë në komunën e Istogut. Zhvillimi i kësaj veprimtarie kërkon plotësimin e së paku tri kushteve:

- njohje zyrtare ndërkombëtare të kujdesit shëndetësor
- dëshmi shëruese

- kualitet i garantuar


Disa nga atraksionet turistike në komunën e Istogut janë:

Parku Kombëtar Bjeshkët e Nemuna - i cili ka marr këtë status të mbrojtjes në vitin 2013 me hyrjen në fuqi të Ligji Nr. 04/L – 086 për Parkun Kombëtar “BJESHKËT E NEMUNA”, shtrihet në 5 komuna të Kosovës: Gjakovë, Junik, Deçan, Pejë dhe Istog, duke përfshirë kështu një pjesë të territorit të komunës së Istogut. Ky Park Kombëtar përfshinë një sipërfaqe prej 62 488 ha prej të cilave 8.1% apo rreth 5 062 ha shtrihen në territorin e komunës së Istogut. Ky Park Kombëtar përfshin vetëm një pjesë të bjeshkëve të Istogut, duke lënë kështu jashtë bjeshkën e Moknës dhe bjeshkët mbi Cerrcë dhe Istog.

Mokna - Sipërfaqja e tërësishme në territorin e komunës së Istogut është 3 905,41 ha dhe shtrihet në gjashtë komuna kadastrale (Zhakovë, Uçë, Shushicë, Cerkolez, Mojstir, Cikor). Nga kjo sipërfaqe, nën pyje gjinden 1 737.18 ha, nën livadhe 460.58 ha, nën kullosa 1685.81 ha dhe sipërfaqe tjera 21.84 ha. Ky territor, me vlerat e tij siç janë: peizazhi natyror, relievi, përbërja gjeologjike, klimatike dhe karakteristikat hidrografike, flora, mbuloja vegjetative dhe fauna, paraqet territor me vlera natyrore dhe estetike dhe ka rëndësi arsimore, shkencore, turistike, rekreative, prandaj në tërësi i plotëson kushtet për mbrojtje si park i natyrës. Ka lartësi mbidetare mbi 1300 m, ndërsa disa maje ngritën edhe mbi 1800 m.

Bjeshka e Moknes apo siç e quajnë ndryshe “bukuroshja e Ballkanit” është një atraksion turistik mjaft i frekuentuar.

Foto 8: Liqeni i Moknës (Burimi i fotos: Klubi Alpin “Podguri” – Istog)



Ndër atraksionet pothuajse më të frekuentuara në Istog është pika vrojtuese (ViewPoint), në qytetin e Istogut, më saktë mbi burimin e Istogut, ku edhe ka frekuentim të madh te qytetarëve nga të gjitha anët e Kosovës. Shtegu i cili qon tek pika vrojtuese ka gjatësi 986 m dhe lartësi mbi detare 758.49m dhe kjo kësaj pike vrojtuese i ofron një pamje mahnitëse të gjithë Podgurit.

Në fotografinë e dytë shihet burimi i ujit në Istog, ndërsa burim të tillë të ujit ka edhe në fshatin Vrellë.

Foto 9. ViewPoint



(Burimi i fotove: Klubi Alpin “Podguri” – Istog)

Pastaj është shtegu i ecjes Istog – Pejë, ofertë e re turistike me sinjalizimet informuese. Ndryshe i quajtur shtegu tematik ndërkufitar me një gjatësi prej 100 km.

Mundësi e turizmit dimëror është shtegu “ViaDinarika” që fillon nga “Sejnova” deri te “Mokna” (41km) – Bjeshkët e Nemuna pjesa veri-perëndimore, me lartësi mbidetare prej 1,800m. Vend i vetëm ku mund të shihen bjeshkët e tërë Kosovës.

Paragliding në “Shoshan” vendosja e stacionit meteorologjik dhe dylbisë për ofrimin e pamjeve magjepsëse të rrafshit të Dukagjinit dhe përcjelljen e fluturimeve me Paragliding në bjeshkët e Istogut, dhe pika e paragliding në “Shymek” e vetmja pikë e paragllajdingut në Kosovë dhe konsiderohet si terreni më i përshtatshëm në tërë Kosovën për këtë lloj sporti.

Foto 10. Stacioni meteorologjik



Foto 11. Paragllajding



(Burimi i fotove: Klubi Alpin “Podguri” – Istog)

Shpella më tërheqëse ViaFerrata, njihen si shpellat më të famshme binjake në Ballkan. ViaFerrata, shpellat binjake gjenden në bjeshkët e Istogut në vendin e quajtur bjeshka e Bajshës në lartësi 1,560 m/lmd , rreth 17 km larg qytetit të Istogut pranë rrugës (Istog – Mokën). Shpellat gjenden në pjesën veriperëndimore të vargmaleve të alpeve shqiptare

(Bjeshkëve të Nemuna).

Foto 12. Shpella binjake – ViaFerrata



(Burimi i fotove: Klubi Alpin “Podguri” – Istog)

KONTAKTET

Genc Ademaj – Drejtor i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, Buxhet dhe Financa

Tel: 049/574-000

E-mail: genc.ademaj@rks-gov.net

Arta Fetahu – Udhëheqëse e Sektorit të Zhvillimit

Tel: 049/766-598

E-mail: arta.fetahu@rks-gov.net